



ora: 13:50

21.05.2023

ANKIM -ADMINISTRATIV

Ankues: Lefter Maliqi, i biri i Novrus dhe Esma, lindur më 10.02.1972 në Berat, banues në Kuçovë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Kuçovë i kualicionit Bashkë Fitojmë, përfaqësuar me Prokurë të Posaçme me Nr. 1411 Rep., Nr. 776 Kol., Datë 21.05.2023 nga avokat Arben Llangzoi me Nr. License 8459 dhe avokate Orgesa Serani me nr. license 9250, anëtar të Dhomës Avokatisë Tiranë, me adresë Rruga "Teodor Keko", pallati Alpha Bank, Hyrja 1, kati 3, Tiranë.

Objekti: Kërkojmë, ndryshimi i Vendimit Nr. 101 datë 16.06.2023 të ZAZ-së Nr. 64 Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, "Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë".

Kërkojmë, rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-në Nr. 64, të gjitha QV-të duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.

Kërkojmë pavlefshmërimë e Vendimit NR. 101 datë 16.05.2023, "Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë".

Kërkojmë konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të KQZ ku është emëruar sekretari i KZAZ, Nr.64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi.

Kërkojmë, pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ, Nr.64 Kuçovë, Qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 11:00 deri në 12:30.

Kërkojmë, pavlefshmërinë e pjeshme të fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashki për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për Bashkinë Kuçovë Qarku Berat Kreshnik Hajdari.

Pavlefshmërinë e veprimit juridik, formularin e dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë K.Q.Z referuar ligjit, nr. 138/2015 'Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.'

Baza Ligjore: Nenet 124 e vijues i Kodit Zgjedhor Nenet: 3, 8, 21, pika 1, gërma "a", neni 26 pika 2, nenet 115, 116, 117, 118, 119, 122, 123/3, 124, 126, 133, 136, 138, 141, 143, 160 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Rregullore Nr. 11, datë 25.03.2021 "Vendim për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit" neni 108 e vijues i K.P.A.

Drejtuar: Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Të nderuar:

1. Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në këto zgjedhje **unë ankuesi Lefter Maliqi kam qënë kanidat për kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.**
2. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave në Bashkinë Kuçovë, KZAZ-ja Nr. 64, me vendimin NR. 101 datë 16.05.2023, miratoi tabelat përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për Kryetar Bashkie të Bashkisë Kuçovë.
3. **Duke qënë se si gjatë zhvillimit të procesit të votimit në këto zgjedhje ashtu edhe gjatë procesit të numërimit të votave, unë ankuesi kam ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe si kam siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të procesit zgjedhor të ndodhura në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr. 64 dhe Qendra të Votimit të Bashkisë Kuçovë, po ju drejtohem me këtë ankim duke kundërshtuar kështu jo vetëm rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë por edhe vetë zhvillimin e procesit të votimit.**
4. **Rezulton se në Bashkinë Kuçovë ushtron detyrën e Kryetarit të Bashkisë Z. Kreshnik Hajdari, i cili kandidon edhe në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 për Kryetar Bashkie si përfaqësues nga Partia Socialiste .** Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Kreshnik Hajdari, rezulton i dënuar nga drejtësia Greke për akuzën e “*Kalimit të Paligjshëm të Kufirit*”, fakt ky i pa deklaruar në formularin e dekriminalizimit. Emri i Kreshnik Hajdarit, që aktualisht drejton nën singlën e PS Bashkinë e Kuçovës dhe aktualisht është kryetar bashkie, ndodhet mes emrave të 18 personave, emigrantë shqiptarë që janë kapur nga policia greke dhe dënuar nga gjykata e Janinës. Vendimin për dënimin e kryebashkiakut Kreshnik Hajdari, është dhënë në vitin 1999 nga gjyqtari i vetëm i gjykatës penale të Janinës, Nicolaos Raptis. Gjyqtari e ka gjetur fajtor dhe dënuar Hajdarin me 1500 Dhrami. Për këtë vendim kryetari i Bashkisë Kuçovë, Kreshnik Hjadari ka patur dijeni të plotë pasi ka qënë prezent gjatë zhvillimit të gjykimit të kësaj çështje. Gjithashtu edhe në një status “squares” sipas tij, për këtë fakt, në llogarinë e tij FACEBOOK e ka pranuar këtë fakt. Në formularin e vetëdeklarimit që Hajdari ka plotësuar, pyetjes standarde nëse ai kishte qënë nën hetim apo gjykim nga ndonjë autorit i huaj, Hajdari i është përgjigjur në kuadratin “JO” fakt ky i pavërtetë dhe e bën formularin e pastërtisë së Figurës të falsifikuar. Me “JO” Hajdari i është përgjigjur edhe pyetjes nr.2 në formular, ku i kërkohet të deklarojë nëse është i dënuar ose jo nga ndonjë autoritet i drejtësisë shqiptare dhe të huaj fakt ky i pavërtetë pasi e vërteta është krejt ndryshe, pasi hajdari rezulton i dënuar. Me JO I është përgjigjur edhe pyetjes tjetër, nëse ka qënë i ndaluar nga organet ligjszbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale, Kreshniku i është përgjigjur me JO, ndërkohë ndodhet mes emrave të 18 personave, emigrantë shqiptarë që janë kapur

nga policia greke dhe dënuar nga gjykata e Janinës. Nëse i referohemi ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" në nenin 5 *Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave* 1. **Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3, të këtij ligji, duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar.** 2. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit. 3. **Formulari i vetëdeklarimit plotësohet vetëm nga personi që është subjekt i këtij ligji. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal.** Ndodhur në Kushtet e mësipërme, bazuar në ligjin LIGJ Nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publik", Shkarkimin e Z. Kreshnik Hajdari nga detyra e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë. Vetë qëllimi i ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publik" është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji dhe objekti i këtij ligji është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, Forcave të Armatosura, organeve të rendit publik, sigurisë kombëtare dhe çdo institucioni apo entiteti tjetër ekonomik shtetëror, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji. Duke qënë se **Z. Kreshnik Hajdari, i cili kandidon edhe në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, për Kryetar Bashkie si përfaqësues nga Partia Socialiste, ka kaniduar në kundërshtim me ligjin atëherë kemi të bëjmë me një veprim të paligjshëm duke printuar në fletët e votimit edhe emrin e këtij kanidati, kur ndrëkohë ky kanidat duhet të ishte çregjistruar dhe fleta e votimit është absolutisht e pavlefshme. Pavlefshmëria, është vetëm për faktin, ku në fletën e votimit është shënuar kanidati Kreshnik Hajdari, pasi Kreshnik Hajdari ka pasyr detyrë të deklaronte Hetimin, Ndalimin dhe dënimin e tij, pasi referuar nenit 1 të ligjit ligj nr. 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Qëllimi dhe objekti 1. *Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik***

të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji. Vet fakti se Kreshnik Hajdari ka dhënë përpara KQZ të dhëna të pavërteta e bënë këtë formular të paqënë pasi një akt i pavlefshëm e bënë atë të mos ketë fuqi juridike. Një tjetër kërkim që ne e kërkojmë përpara jush është dhe fakti i pavlefshmërisë së veprimit juridik, dhe pikërisht formularin e dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorzuar pranë K.Q.Z referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publik”, kjo deklaratë është dhënë në **kundërshtim me ligjin nr. 138/2015** dhe si e tillë është absolutisht e pavlefshme, në kuptim të Nenit 92/ç e vijues i Kodit Civil është një deklaratë që ka patur për qëllim të sjellë si pasojë juridike atë pasojë të cilën ka passjellë. Veprime juridike të pavlefshme janë të përcaktuara në mënyrë të qartë në Nenin 92 të kodit civil dhe Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: **a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).**

5. Sekretari i KZAZ, shtetasi Romeo Arizi ka qënë i emëruar në kundërshtim me ligjin në detyrën e tij. Kodi Zgjedhor në nenin 29 parashikon se: *Përbërja e KZAZ-së (Ndryshuar pika 5, me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012) 1. KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme: c) sekretari i KZAZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga partia, e cila propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së; edhe në në 31 të Kodit Zgjedhor kemi të bëjmë me kushtet për emërimin e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së Anëtar dhe sekretar i KZAZ-së mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme: a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës; b) ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist; c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse; ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme. Pra kemi dy dispozita ligjore që parashikojnë në mënyrë taksative se sekretari i KZAZ duhet të jetë jurist. Por sekretari i KZAZ Nr. 64 në Kuçovë është naftëtar dhe jo jurist. Ushtrimi i detyrës së komisionerit nga ana e sekretarit të KZAZ, në procesin tim të numërimit, cënon në mënyrë të drejtpërdrejtë, Nenin 4 të Kodit të Proçedurave Administrative i cili ka të bëjnë me Parimin e ligjshmërisë 1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. Ushtrimi i detyrës së naftëtarit (sekretarit të KZAZ), në pozicionin e juristit, na krijon bindjen se është dhe në kundërshtim me Neni 13 të Kodit të Proçedurave Administrative,*

që ka të bëj me, Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. Pra në rastin konkret çenohet ekzistenca e një procesi efektiv dhe të pavarur, pasi ligjvënsi jo paqëllim ka vendosur detyrim ligjor faktin se sekretari duhet Jurist, kjo është bërë për egzistencën e një standardi, me qëllim realizimin e misionit të tyre – dhënien e drejtësisë dhe jo rrumpallizimin e procesit. Në këtë vështrim respektimi i kriterëve ligjore, ndikon drejtpërsëdrejti në garantimin e shtetit të së drejtës. Ushtrimi i detyrës në kundërshtim me K.P.A, na krijon bindjen se ky punonjës është në detyrë dhe në kundërshtim me nenin 30 të K.P.A. që ka të bëjë me Pengesat ligjore, ***Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:h) në çdo rast kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi. Dhe në legjislacionin në fuqi kemi detyrim ligjor nenin 29 parashikon se c) sekretari i KZAZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga partia, e cila propozon zëvendëskryetarin e KZAZ-së; dhe njëkohësisht i njëjti detyrim ligjor është dhe në nenin 31 pika b) të kodit zgjedhor, ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist. Pasoja e emërit të naftëtëtarit në pozicionin e juristit kqa sjellë shkelje të rëndë në process dhe në procedurën e numërimit të votave.*** Në rastin aktual nga ana jonë kërkohet pavlefshmëria absolute e një akti administrative është forma më e rëndë e pavlefshmërisë së aktit, pasi akti është nxjerr në kundërshtim flagrant me ligjin dhe me kompetencën e organit administrative pra akti administrative është në kundërshtim me nenin në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili bën fjalë për rastet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ është parashikuar se: ***“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme: a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i pidentifikuar; b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji”.***

6. Në nenin 34 të Kodit Zgjedhor janë përcaktuar detyrat e sekretarit të KZAZ-së, një ndër të cilat është dhe parashikimi ligjor se ***dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZAZ-ja dhe i vulos ato; zbardhje e vendimit do të thotë arsyetim vendimi. Vendimi nuk mund të arsyetohet nga naftëtari për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar në nenin 29 dhe 31 të Kodit zgjedhor, por nëse i referohemi zbardhjes së vendimit NR. 101 datë 16.05.2023, i cili miratoi tabelat përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për Kryetar Bashkie të Bashkisë Kuçovë, ky vendim nuk është shkruar dhe nënshkruar apo zbardhur nga naftëtari Romeo Arizi, por rezulton i fallsifikuar shkrimi në emër të tij. Shif akt ekspertimin e paraqitur në cilësinë e provës.***
7. Një tjetër veprim i paligjshëm është dhe vendimit KZAZ Nr. 64 Kuçovë qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 11:00 deri në 12:30. Ky vendim ndodhet në librin e vendimeve të KZAZ Kuçovë . Ky vendim është nxjerrë na KZAZ një vendim i cili duhej të nxirej nga KQZ . Duke qënë se ky vendim është zgjedhur nga organi jo kompetent atëherë ne kemi të bëjmë me pavlefshmëri absolute, akti është nxjerr në kundërshtim

flagrant me ligjin dhe me kompetencën e organit administrativ, pra akti administrative është në kundërshtim me nenin në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili bën fjalë për rastet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ është parashikuar se: *“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme: a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji”*.

8. **Rreth 3.000 vota në kutitë e fundit janë të pavlefshme dhe nuk kuptohet se ku është vendosur shënimit të emri i kandidatit. Ky fakt është konstatuar por nuk është vendosur që këto vota të deklarohen të pavleshme. Kjo vjen për faktin se naftëtari nuk ka qënë i kujdesshëm në organizimin dhe mirfeksionimin e procesit zgjedhor. Sipas parashikimeve të kodit zgjedhor në nenin 34 pika a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së;**
9. **Gjatë Procesit të votimit ka pasur probleme me kamerat e sigurisë në pjesën më të madhe të qendrave gjatë gjithë paradites. Një fakt ky që nuk tregon se kemi transparencë dhe siguri për të garantuar votën e lirë, por janë krijuar kushte për të përgatitur vjedhjen me çdo kusht të votës. Ky fakt, pra mungesa e sistemit të sigurisë, ka qënë një mangësi ligjore e cila ka qënë detyrim ligjor. Në kodin zgjedhor, e pikërisht në nenin 22 pika 2, përcaktohet qartë se *KQZ-ja ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sisteme videomonitorimi në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërimi manual i votave, në VNV-të, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre. Sistemi i videomonitorimit nuk mund të instalohet në qendrat e votimit në mënyrë të tillë që të cenojë ose të rrezikojë kryerjen në fshehtësi të votimit. Nëse nuk e kryen vetë, KQZ-ja ka të drejtë të prokurojë instalimin ose edhe operimin e sistemit të videomonitorimit. Pra , vota duhet të sigurohet dhe gjatë procesit të votimit ashtu sikurse edhe gjatë procesit të numërimit, duke u monitoruar më kamera sigurie. Mungesa e monitorimit me kamera sigurie, bie ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor, por edhe me nenin 19 të Vendimit Nr.11, datë 25.03.2021 “Vendim për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimi”, në të cilin parashikohet se: *“1. Për të provuar rregullshmërinë e procesit të votimit, në mjediset e brendshme të çdo QV-je vendoset një kamera për video regjistrim, me specifikime teknike sipas lidhjes 3 bashkëlidhur këtij Vendimi. Përdorimi i kamerës në QV kryhet sipas rregullave të përcaktuara në lidhjen 3 bashkëlidhur këtij vendimi. 2. Personi i ngarkuar me detyrë nga KQZ për funksionimin e kamerës, vendos mbajtësen dhe kamerën duke iu referuar planvendosjes orientuese sipas skemës tip bashkëlidhur Udhëzimit nr.1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së endrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhje”. Procesi i regjistrimit video fillon me paraqitjen e anërvëve të KQV në qendrën e votimit dhe vijon****

në mënyrë të pandërprerë deri kur KQV me kutinë/të e votimit, kutinë e materialeve të votimit, dhe operatori teknik me pajisjen PEI largohen nga QV për dorëzimin e tyre në VNV. 3. Personi i ngarkuar me detyrë nga KQZ për mbikqyrjen e funksionimit të kamerës, në momentin e ndezjes së saj dhe gjatë ditës së votimit, njofton menjëherë asistencën teknike për probleme të mosfunksionimit. 4. Kryetari, sekretari, dhe çdo anëtar tjetër i KQV-së, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk kanë të drejtë ndezin, fikin apo shkëpusin lidhjen e kamerës me rrjetin elektrik dhe/ose të ndryshojnë pozicionin e saj. 5. Materiali video i regjistruar nga kamerat në mjediset e brendshme të QV-ve ruhet në KQZ deri në përfundim të verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike. Pas përfundimit të kësaj periudhe, materiali ruhet në përputhje me ligjin "Për arkivat". Informacioni i regjistrimit video mbrohet sipas ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar." **Me qëllim, vëretimin këtij fakti**, kërkojmë KQZ marrjen e pajisjeve me regjistrimet e kamerave si në qendrat e votimit ashtu edhe në qendrat e numërimit në këtë zonë.

10. Një tjetër fakt që është i provuar se kemi të bëjmë me shkelje të procedurave ligjore dhe manipulim të votave është dhe fakti se në Qv 3516 Vodëz (shkolla 9-vjeçare) Njësia Lumas, në kutinë e votimit për Këshillin Bashkiak ka patur kundërshtim nga anëtarët e GNV Nr. 3 Xhafer Haxhillari dhe Qazime Dardha me shënimin se **nuk u gjendën fletat e mbylljes së kutisë as në kutinë e votimit dhe as në kutinë e materialeve e cila nuk i kishte të saktësuar saktë Procedurat. Kutisë së materialeve nuk i përputheshin vulat. Vulat ishin të shënuara ndryshe në procesverbalin e gjetur. Procesverbalit të gjetur nuk i përputheshin të dhënat. Të dhënat nuk ishin shënuar me fjali. Procesverbali nuk mbante as datën dhe as orën e mbylljes, as nr. e QV, as Procesverbalin e mbylljes.** Ky fakt tregon se kemi të bëjmë me ndërrim të vulave dhe dëmtim të materialeve zgjedhore. Në nenin 113 të Kodit Zgjedhor është e përcaktuar qartë se : Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mbyllet në kutinë e materialeve zgjedhore: a) zarfi "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA"; b) zarfi "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA"; c) lista e zgjedhësve, përfshirë edhe regjistrin e posaçëm, sipas nenit 57 të këtij Kodi; ç) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së; d) vula e KQV-së; dh) vula e kryetarit të KQV-së; e) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura; ë) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara; dhe f) Libri i Protokollit të Mbledhjeve. 62 6. Numrat e kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, shënohen paraprakisht në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pasi hidhen të gjitha të dhënat në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, shënohet ora e saktë e mbylljes së procesverbalit. Origjinali i Procesverbalit për Mbylljen e Votimit futet në kutinë e votimit, e cila vulolet menjëherë me kodin e fundit të sigurisë, ndërsa kopja futet në kutinë e materialeve të votimit, e cila më pas vulolet me kodet përkatëse të sigurisë. Kopje të Procesverbalit për Mbylljen e Votimit u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare. 7. Në rast

se gjatë mbylljes së kutisë së votimit vula me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë, ajo zëvendësohet me një nga vulat shtesë. Në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar. 8. Procesverbali i Mbylljes së Votimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Nëse ndonjë nga anëtarët e KQV-së ka vërejtje, ato shënohen në hapësirën e posaçme për vërejtjet në procesverbal. **Procedurë e cila nuk është respektuar në rastin konkretë**. Këto veprime vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe procedurat e caktuara në aktet e Komisionit Rregullator pranë KQZ dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për sa i përket pasqyrimin real dhe të vërtetë të vullnetit të zgjedhësve. Kjo rrethanë përbën shkak ligjor sipas parashikimeve të nenin 160 dhe provon se vendimi i KZAZ-se që kundërshtojmë dhe gjithë procedura e mëpasshme që përfundon me miratimin e tabelës përmbledhëse nga KQZ janë marrë në kundërshtim të hapur me ligjin.

11. Një tjetër fakt që është i provuar se kemi të bëjmë me manipulim të votave është dhe fakti se në Qv 3417 Krekëz (shkolla fillore), Njësia Lumas, Probleme me pajisjen PEI, është votuar manualisht për 50 qytetarë, 45 prej të cilëve nuk figurojnë në sistemin TIMS brënda Territorit të Republikës së Shqipërisë në ditën e votimit. Nga informacionet që kemi marrë në rrugë operative, një prej tyre është shtetasi **Lavdimir Qemal Tomorri dtl. 11.02.1985** i cili është larguar në Greqi që më 27.02.2023, ky fakt është një indicie për të hetuar çdo kuti ku nuk ka punuar sistemi kamerave dhe pajisja PEI. Përpos shkeljes administrative, e në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, ku në nenin 105 janë të parashikuara rregullat për paraqitjen e zgjedhësve në qendrën e votimit, këto veprime përbëjnë edhe vepër penale të parashikuar nga Neni 326 'Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve'; Neni 327/a 'Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar'; Neni 331/a 'Marrja ose përdormi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit'. Me qëllim verifikimin e këtij fakti, kërkojmë nga ana juaj që ti drejtoheni në mënyrë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit e cila ka akses në sistemin TIMS, me qëllim verifikimin e personave të cilët kanë votuar në këtë qendër, rezultojnë në Shqipëri apo jashtë saj.
12. Në Qv 3528/01 Lgj. Nr. 2 Bll. "Llukan Prifti", "Teknikumi" në kutinë e votimit për Këshillin Bashkiak ka patur kundërshtim nga anëtarja e GNV Nr. 3 Qazime Dardha me shënimin se Procesverbali i mbylljes ishte gjetur i pa vulosur. Po ashtu edhe në Qv 3530 Lgj. Nr. 2 Bll. "Llukan Prifti", "Teknikumi" në kutinë e votimit për Këshillin Bashkiak ka patur kundërshtim nga anëtarja e GNV Nr. 3 Qazime Dardha me shënimin se **Procesverbali i mbylljes ishte gjetur i pa vulosur**. Këto rrethana provojnë se kemi të bëjmë me hapje të vulave dhe mos vulosje të kutive të materialeve zgjedhor, ky fakt tregon se kemi të bëjmë me ndërrim të vulave, dhe mundësi aksesimi në rezultatin zgjedhor.
13. Në Qv 3525/00 Lgj. Nr. 2 Bll. "1 Maji", Shkolla "Gaqi Karakashi" ka patur votim në grupe, votim jashtë qendrës të kapur në foto nga vëzhguesit.

Po ashtu edhe në Qv 3525/00 Lgj. Nr. 2 Bll. "1 Maji", Shkolla "Gaqi Karakashi" ka patur votim në grupe, votim jashtë qendrës të kapur në foto nga vëzhguesit.

Në Qv 3525/01 Lgj. Nr. 2 Bll. "1 Maji", Shkolla "Gaqi Karakashi" ka patur votim në grupe, votim jashtë qendrës të kapur në foto nga vëzhguesit. P

robleme me kamerat e sigurisë në Qv 3525/02 Lgj. Nr. 2 Bll. "1 Maji", Shkolla "Gaqi Karakashi" si dhe ka patur votim në grupe, votim jashtë qendrës të kapur në foto nga vëzhguesit. Edhe në Qv 3527/00 Lgj. Nr. 2 Bll. "Llukan Prifti", "Kopshti Nr. 3" ka patur votim në grupe, votim jashtë qendrës të kapur në foto nga vëzhguesit.

Në Qv 3527/01 Lgj. Nr. 2 Bll. "Llukan Prifti", "Kopshti Nr. 3" ka patur votim në grupe, votim jashtë qendrës të kapur në foto nga vëzhguesit.

Veprime këto të cilat bien në kundërshtim me Kodin Zgjedhor e konkretisht me Nenin 109/2 të tij, në të cilin është përcaktuar qartë se 2. Në qendrën e votimit nuk lejohet përdorimi i telefonisë celulare nga ana e zgjedhësit dhe zgjedhësi nuk duhet të lejohet të votojë duke mbajtur aparatën telefonikë në dorë. Nëse zgjedhësi tenton të përdorë aparatën e telefonisë apo çdo pajisje tj jetër regjistrimi në dhomën e fshehtë, zbatohet e njëjta procedurë si në pikën 1 të nenit 107. Ku në nenin 107 pika 1 përcaktohet qartë se 1. Nëse shënimi në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i KQV-së merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E DËMTUAR" dhe e fut atë në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA". Në këtë rast, zgjedhësi i jepet një fletë votimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.

- 14. Gjatë dorëzimit të kutive janë konstatuar parregullsi dhe janë dorëzuar dorazi vulat nga komisionerët dorëzues të disa qendrave, prej të cilave njëra është fshehur prej Kryetarit të KZAZ Erald Shushari në kartonin e vulave të sigurisë e provuar kjo me fotografitë përkatëse. Në Kodin Zgjedhor dhe pikërisht në nenin 113 pika 5 të tij është e parashikuar qartësisht se 5. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mbyllën në kutinë e materialeve zgjedhore: a) zarfi "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA"; b) zarfi "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA"; c) lista e zgjedhësve, përfshirë edhe regjistrin e posaçëm, sipas nenit 57 të këtij Kodi; ç) origjinalet e vendimeve të KQV-së dhe formularët tip të papërdorur të vendimeve të KQV-së; d) vula e KQV-së; dh) vula e kryetarit të KQV-së; e) vulat me kodet e sigurisë të papërdorura; ë) vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara; dhe f) Libri i Protokollit të Mbledhjeve. Pra në asnjë dispozitë ligjor nuk parashikohet se depozitimi i vulave bëhet dorazi, për më tepër që në rastin rastin konkretë kemi edhe fshehje të vulës, e provuar kjo nëpërmjet fotografimit.**

15. **Gjatë Procesit të Numërimit: Sipas Protokollit të Përmbledhjes së KZAZ është mbajtur shënim gjatë procesit zgjedhor se:** Q.V.3424/01 njoftoi KZAZ kanë dëmtuar vulat pasi kanë vulosur gabimisht kapakun e materialeve zgjedhore në kutinë e votimit për Kryetarin e Bashkisë. Duke qënë se ky kapak nuk ka carje për lejimin e votimit, janë dëmtuar vulat dhe është vendosur sërish kapaku i kutisë së votimit për K.B. Qendra Vendore kërkon dhe 2 (dy) vula të tjera shtesë për vullosjen e kutisë. KZAZ vendosi të pajisë këtë Q.V. me 2 (dy) vula shtesë me kode: 024824 dhe 024827. Këto rrethana provojnë se kemi të bëjmë me hapje të vulave dhe mos vulosje të kutive të materialeve zgjedhor, cka tregon mundësi aksesimi për ndikim në vota dhe rrjedhimisht rezultata zgjedhor.
16. E njëjta dhe me një qëndër tjetër ku u pajis me vulën 024823 (shënimi gjendet në librin e protokollit. Anëtarët e grupit të numërimit pasi numëruan kutinë me numër qëndre 3416, kanë mbyllur në kuti zarfin pa bërë raportimet për numrin e votuesve gra dhe burra. Për këtë arsye vendoset rihapja e kutisë. Rihapet dhe vendosen këto kode... QV 3415 kanë mbyllur kutinë pa plotësuar të gjithë zërat e kërkuar te tabela e rezultateve, kutia rihapet dhe vendosen këto kode... QV 3501 rihapet kutia e materialeve për mospërputhje votash. I jepen vula sigurie.... Grupi i numërimit nr. 3 që po numëron QV Nr. 3513 **kostaton se vulat e mbylljes nuk përputhen dhe njoftoi KZAZ dhe KZAZ për këtë fakt se me vulat e kutisë së Këshillit B, ishte mbyllur Kutia e Votimit për Kryetar B., KZAZ vendos të Ri-hap Kutitë e materialeve.**
17. Kutisë së numërimit me Nr. 3516 i mungon procesverbali i mbylljes. KZAZ vendos të hap kutinë e materialeve për QV: 3518; 3519; 3519/1. Në QV. 3523 u konstatuan 2 vota të cilat u kundërshtuan nga anëtarja e BF. U mblodh KZAZ dhe vendosi t'i quajë të pavlefshme. Votuar PRO nga 6 anëtarë dhe 1 Kundërshtuar. Fakt që tregon se kemi të bëjmë me një manipulim të votuesve dhe se duhet të hetohen komisionerët e QV 3518; 3519; 3519/1. Me këtë veprim, duke i nxjerrë dy fletë votimi të pavlefshme ndërkohë që nuk janë të tilla.
18. E njëjta gjë është konstatuar edhe në QV. 3525/03, **në kutinë e Kryetarit të Bashkisë nuk u gjend procesverbali i mbylljes së votimit dhe për këtë arsye do të hapet kutia e materialeve zgjedhore. Edhe në** Në QV. 3516 për shkak se nuk është gjendur procesverbali i mbylljes, KZAZ vendosi të pajisë GNV me 4 (katër) vula shtesë. E njëjta gjë dhe për QV.: 3519/1. **Edhe në** QV 3528/01 në kutinë e votimit për Këshillin Bashkiak proces verbali i mbylljes (kopja) është gjetur pa vulën e qendrës së votimit. GNV njoftoi KZAZ e cila vendos rihapjen e kutisë së Kryetarit.
19. I jepen GNV 4 (katër) vula për kutinë e fletëve të hedhura gabim. Në këtë kuti pra në kutinë e fletëve të hedhura gabim për Kryetarin e Bashkisë, janë gjetur fizikisht 13 fletë votimi, por meqenëse në sistem në momentin e ri-hapjes së kutisë për numërim në Tav Nr. 1 të numërimit në Sistemin elektronik rezultoni 7 fletë është kërkuar nga Anëtarët PS

Numërues të tavolinës por edhe të KZAZ PS, të mbulohej duke i shënuar këto katër vota mungesë sikur janë gjendur të pavlefshme, kjo është kundërshtuar nga anëtari numërues i BF, duke lënë shënimin përkatës në fletën e numërimit.

20. E njëjti skenar mbulimi të mos rakordimit në nr. votash fizikisht në kuti me atë të shënuar në process-verbale ka ndodhur në qendrat 3525/00; 3526/00 etj. Gjatë numërimit dhe janë rakorduar shifrat me të pavlefshmet që në fakt nuk ndodheshin fizikisht aty. Nëse hapet sistemi i kamerave do të dallohen kundërshtitë e komisionit të numërimit lidhur me këtë fakt i cili nuk është shënuar në asnjë rast në librin e protokollit. Emrat e Komisionerëve që kanë dijeni për këtë janë Alit Daulle, Alma Cela, Kreshnik Lici, **Edmond Matarangasi**. **Theksojmë se ka patur shumë mos rakordime në numër votash në çdo tavolinë kjo për faktin e prishjes dhe falsifikimit të materialit zgjedhor.** Votat (në disa kuti) në kutitë e Kandidatit për Kryetar Bashkie, ishin të njollosura me bojë vule, në disa raste nuk dallohej dot prej bojës as shenja e votimit dhe u mor vendim nga KZAZ që gjithësesi të kalonin si të vlefshme pasi ka patur probleme me bojën e vulave.
21. Në librin e protokollit është shënuar nisja e votimit në orën 24:00, por në fakt për shkak të një shkëputje pushimi të paarsyetuar mirë të disa anëtarëve të KZAZ (me vendim të vetëm 4 anëtarëve) rreth orës 11:15, u shty në orën 12:30. Kjo është shënuar edhe në Librin e Vendimeve. Largimi i personave të caktuar për numërimin e votave pa arsye përbën braktisje e detyrës, në asnjë dispozitë ligjore nuk gjen mbështetje justifikimi i tyre për braktisje të detyrës për bërje dushi nga ana e antarëve të komisionit, kjo ka qënë me qëllim manipulim e votave dhe rezultatit zgjedhor referuar kjo edhe faktit të mos sigurimit të kutive të votimit gjatë kësaj kohë. Kutitë kanë qëndruar në një ambient jo të sigurt, me dyer të hapura e lehtësisht të aksesueshme me qëllim ndërhyrjen në to. Mos sigurimi i vëndit të ruajtjes së kutive, duke i lënë ato në vende të aksesueshme e për rrjedhojë mundësi manipulimi në rezultat zgjedhor, cënon në mënyrë të drejtëpërdretë votën e lirë të qytetarëve të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe një sërë dispozitash të tjera ligjore.
22. Përpara fillimit të numërimit është kostatuar nga KZAZ, mosfunksionimi i mirë i kamerës së sigurisë, e cila nuk mbulonte dot as tavolinën nr. 5 të numërimit dhe aspak ambientin shtesë ku vendoseshin materialet dhe pajisjet PEI tek e cila pas një dollapi në këtë ambient shtesë ka patur një derë të mirëfilltë kalimi lidhëse me ambientet e pandricuara të shkollës së Mesme ngjitur, pasi qendra ishte e pajisur me vetëm një kamera sigurie në katër dimensional, e jo si herët e tjera me nga një kamera për tavolinë, dhe as dhoma shtesë e materialeve nuk kishte kamera sigurie. Ndërkohë që sipas Kodit Zgjedhor, e pikërisht në nenin 94 pika 5 të tij ndër të tjera është përcaktuar qartë se “...KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. **Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi.** Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë

vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në medie elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. KQZja ose, kur është e mundur, edhe KZAZ-ja, duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore kundrejt pagesës së një tarife që mbulon koston e riprodhimit.”

23. Në listën e Kandidatëve për këshillin Bashkiak ndodhen dy individë që i kanë shërbyer në funksione edhe procesit të votimit dhe numërimit përkatësisht: Klajdi Pirja Nr. 32 në listën për Anëtarët e Këshillit Bashkiak rezulton gjithashtu se ka qënë përdoruesi i Paisjes PEI në një qendër votimi. Alit Daulle Nr. 1 në listën për Anëtarët e Këshillit Bashkiak rezulton gjithashtu se ka qënë numërues gjatë gjithë procesit të numërimit. Veprimtaria e tyre është e paligjshme, dhe bien ndesh me nenin 3 të Ligjit “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, në këtë dispozitë ligjore parashikohet se “Konflikti i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike. Pasi në rastin konkretë vetë kandidati për antar të Këshillit Bashkiak, numëron votat e tij. Në këtë proces votimi ka patur gjithashtu të përfshirë punonjës bashkie dhe funksionarë që kanë shërbyer respektivisht si më poshtë, Misir Toska Komisioner (punonjës bashkie dhe kryeplak) Skënder Mecaj (punonjës bashkie) Klaudio Kasaj (punonjës bashkie) Albion Pirko (punonjës bashkie) Altin Dauti (punonjës bashkie) Sokol Vasili (punonjës bashkie). Fakt ky që bije ndesh me kodin zgjedhor
24. Në KUTITË NR. 3517/01 mungonte Procesverbali origjinal i mbylljes. Në KUTITË NR. 3523/01 mungonte Procesverbali origjinal i mbylljes. Në KUTITË NR. 3525/00 mungonte Procesverbali origjinal i mbylljes. Në KUTITË NR. 3525/03 mungonte Procesverbali origjinal i mbylljes. Në KUTITË NR. 3525/03 mungonte Procesverbali origjinal i mbylljes. Në KUTITË NR. 3529/00 mungonte Procesverbali origjinal i mbylljes. Në KUTITË NR. 3527/00 mungonte Procesverbali origjinal i mbylljes. Po ashtu edhe në KUTITË NR. 3517/01 Mungonte edhe Procesverbali origjinal i vulosjes së kutive. Veprime këto të kryera qëllimish, me qëllim manipulimin e rezultatit zgjedhor. Pasi brënda në kuti janë futur procesverbale të fotokopjuar për të cilat kemi dyshime se janë të falsifikuara, e me qëllimin e vetëm atë të manipulimit të rezultatait zgjedhor. Pasi referuar edhe aktit të ekspertimit që ne kemi kryer kemi të bëjmë me falsifikime të qarta
25. Për të provuar sa më sipër parashtruam, kërkojmë kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjeve me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në ZAZ-në 64. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë se numrit të votave të vlefshme, apo të përfshira si vota të vlefshme për një tjetër kandidat, është relativisht i lart. Nga leximi i këtyre anomalive apo parregullsive në kualifikimin jo të rregullt të votës, rezulton se Kandidatit të Koalicionit duhet t'i shtohen të paktën votat për të cilin ai ka humbur mandatin, kjo

sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e zaz. Pra natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme këqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final rinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi, ku nga leximi i materialit filmik, konstatohet qartë se vota e Kandidatit të Koalicionit është shpërdoruar dhe adresuar qëllimshëm në një tjetër kandidat, dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.

26. Për të provuar sa më sipër parashtruam, kërkojmë kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjeve me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në ZAZ-në 64. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë se numrit të votave të vlefshme, apo të përfshira si vota të vlefshme për një tjetër kandidat, është relativisht i lart. Nga leximi i këtyre anomalive apo parregullsi në kualifikimin jo të rregullt të votës, rezulton se Kandidatit të Koalicionit duhet t'i shtohen të paktën votat për të cilin ai ka humbur mandatin, kjo sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e zaz. Pra natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme këqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final rinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi, ku nga leximi i materialit filmik, konstatohet qartë se vota e Kandidatit të Koalicionit është shpërdoruar dhe adresuar qëllimshëm në një tjetër kandidat, dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.

Po ashtu, kërkojmë edhe marrjen e provës , e konkretisht verifikimin në sistemin Tims për personat të cilat nuk rezultojnë në shtetin Shqiptar , e të cilët figurojnë sikur kanë votuar.

